



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Gilgocit
Opština Gilgovac
Municipality of Gilgoc

Në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 11 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13 paragrafi 3, nenit 23 paragrafi 1, nenit 24 paragrafi 1, 4 dhe 5, nenit 25 paragrafi 1 dhe 3, nenit 35 paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballeshëm, Shtojcën 1, Komponenti 1 dhe 2 të Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” e ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”, Kodin Buxhetor 18987 të paraparë në Ligjin Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar më 23.12.2024 ndërmjet MMPH-së dhe Komunës, si dhe Thirrjes për Aplikim të datës 25.07.2025, palët e kësaj Marrëveshje për Grant (tani e tutje Marrëveshja):

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në vijim: “MMPH-së”), e përfaqësuar nga znj. Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në detyrë,

dhe

2. Komuna e Drenasit (në vijim: “Komuna”), e përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës,

lidhin këtë:

MARRËVESHJE PËR GRANT PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË BANIMIT

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Marrëveshjeje ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e MMPH-së dhe Komunës së Drenasit lidhur me zbatimin e Programeve të Banimit, të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Marrëveshje zbatohet për Programet e Banimit të miratuara për Komunën e Drenasit të përfshira në Shtojcën 1 të kësaj marrëveshje dhe të financuara si nënprojekte në kuadër të Projektit “Banimi Social Adekuat” për periudhën 2026–2028, sipas planifikimeve buxhetore përkatëse.

Neni 3

Përgjegjësitë e MMPH-së

1. MMPH është përgjegjëse të:

1.1. Shqyrtojë dhe miratojë Programet e Banimit të hartuara nga Komuna për të siguruar përputhshmërinë me objektivat dhe kriteret e Programit;

1.2. Koordinojë, menaxhojë dhe monitorojë shpërndarjen dhe përdorimin e grantit për Programet e Banimit, të siguruar në kuadër të Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) të ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

1.3. Sigurojë, në kuadër të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, si dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028, buxhetin e nevojshëm për zbatimin e Programeve të Banimit të miratuara në përputhje me këtë Marrëveshje;

1.4. Menaxhojë, përmes Njësitit të Menaxhimit të Projektit (tani e tutje NjMP), zbatimin e Programeve të Banimit pas miratimit të secilit Program të Banimit, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Manualin e Implementimit të Projektit (tani e tutje MIP);

1.5. Ofrojë mbështetje teknike dhe asistencë profesionale përmes NjMP-së për Njësinë e Implementimit të Projektit (tani e tutje NjIP) të Komunës gjatë të gjitha fazave të zbatimit të Programeve të Banimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës

1. Komuna e Drenasit është përgjegjëse që të:

1.1. Zbatojë secilin Program të Banimit përmes NjIP në Komunë;

1.2. Sigurojë përputhshmërinë me kushtet e planifikimit hapësinor dhe të gjitha lidhjet dhe instalimet përkatëse të infrastrukturës/shërbimeve për lokacionin e realizimit të Programit të Banimit (furnizimi me ujë, kanalizimi, energjia, rrugët etj.);

1.3. Kryej të gjitha veprimet lidhur me projektimin dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik të kërkuar, si dhe të menaxhojë procesin e zbatimit të Programit të Banimit sipas (MIP), duke përfshirë:

- 1.3.1. Përgatitjen e Termave të Referencës;
- 1.3.2. Detyrën Projektuese;
- 1.3.3. Rishikimin e Projektit, në përputhje me MIP;
- 1.3.4. Realizimin e Procedurave të Prokurimit;
- 1.3.5. Menaxhimin e kontratave për punimet ndërtimore dhe mbikëqyrjen e ndërtimit.

1.4. Zbatojë procedurat ligjore dhe të pajisjes me leje ndërtimore në përgjegjësi të komunës (kushtet ndërtimore, lejen ndërtimore, certifikatën e përdorimit etj.);

1.5. Bashkëpunojë në mënyrë transparente me MMPH, përmes NjMP, dhe të raportojë progresin në përputhje me udhëzimet e MIP-së;

1.6. Kur është e zbatueshme, të sigurojë banim të përkohshëm për përfituesit që nuk kanë mundësi të sigurojnë zgjidhje banimi, gjatë fazës së renovimit të njërive të banimit social ose gjatë renovimit dhe rindërtimit të shtëpive private për familjet e cënueshme;

1.7. Mirëmbajë dhe përditësojë të dhënat e përfituesve në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.8. Sigurojë që secili Program i Banimit të përgatitet dhe të zbatohet në përputhje me Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (tani e tutje KMMS) dhe dokumentacionin teknik të miratuar si dhe me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë, sipas rastit:

- 1.8.1. Vlerësimin mjedisor dhe social dhe identifikimin e rreziqeve dhe masave përkatëse;
- 1.8.2. Sigurimin e lejeve, vendimeve dhe miratimeve të nevojshme;
- 1.8.3. Verifikimin e çështjeve që lidhen me tokën dhe të drejtat përkatëse;
- 1.8.4. Informimin dhe konsultimin e palëve të interesit;
- 1.8.5. Menaxhimin e ankesave;
- 1.8.6. Mbrojtjen e personave të cënueshëm dhe personave të prekur nga realizimi i programit të banimit;
- 1.8.7. Shëndetin dhe sigurinë në punë;
- 1.8.8. Monitorimin e përputhshmërisë gjatë zbatimit;
- 1.8.9. Zbatimin e kërkesave për efikasitet të energjisë në ndërtesa.

1.9. Të sigurojë që dokumentet e prokurimit dhe kontratat për projektim, mbikëqyrje dhe punime zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e BZHIKE-së, dokumentacionin kryesor teknik, KMMS dhe MIP-së dhe të përfshijnë:

- 1.9.1 detyrimet e zbatueshme mjedisore dhe sociale që rrjedhin nga KMMS-ja,
- 1.9.2. politikat e Mjedisit dhe Mbrojtjes Sociale (PMMS-të);
- 1.9.3. listat kontrolluese specifike për lokacionin;
- 1.9.4. vendimet e vlerësimit dhe kushtet e lejeve;
- 1.9.5. asnjë punim të mos fillojë para se të jenë siguruar instrumentet dhe miratimet e nevojshme mjedisore dhe sociale.

1.10. Mbjë evidencë të saktë për të gjitha aktivitetet, shpenzimet apo kontributet komunale në kuadër të zbatimit të Programeve të Banimit, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”.

Neni 5

Mënyra dhe shuma e financimit

1. MMPH do të sigurojë financimin e nevojshëm për zbatimin e Programeve të Banimit, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”, si dhe me ndarjet buxhetore sipas Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, sipas kodit buxhetor 0650 - Programi i Banimit Social, në kuadër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028 dhe asaj pasuese, por më së largu deri në datën e mbylljes së Projektit “Banimi Social Adekuat” më 31 Dhjetor 2031.

2. Për qëllime të planifikimit dhe zbatimit të Programeve të Banimit, shuma indikative e financimit të ndarë për Komunën për zbatimin e Programeve të Banimit të miratuara nga MMPH sipas kësaj Marrëveshjeje vlerësohet deri në EUR 3,010,000, e cila është e bazuar në aplikimin Komunës për Programet e Banimit, vlerësimet paraprake të kostos dhe ndarjen paraprake të fondeve në kuadër të Programeve të Banimit, dhe do të mbetet çështje e përcaktimit përfundimtar pas përfundimit të procedurave të projektimit dhe prokurimit. Shuma indikative e financimit sipas Programeve të Banimit është përfshirë në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Shuma e saktë e financimit për secilin Program të Banimit përcaktohet përfundimisht pas hartimit të projektit kryesor dhe përfundimit të procedurave të prokurimit dhe dhënies së kontratës, bazuar në vlerën përfundimtare të kontraktuar.

4. Nëse kostoja përfundimtare e Programit të Banimit tejkalon shumën e vlerësuar fillimisht sipas paragrafit 2 të këtij neni, apo gjatë zbatimit shuma tejkalon vlerën e kontratës përmes punëve shtesë të lejuara me Ligjin përkatës të Prokurimit Publik, mbulimi i kostove shtesë mund të bëhet vetëm me marrëveshje paraprake me shkrim ndërmjet palëve, në kuadër të fondeve të disponueshme, ndarjeve buxhetore të miratuara. Një kosto e tillë shtesë mund të ndahet në mënyrë proporcional në mes të MMPH-së dhe Komunës, sipas përqindjes së bashkëfinancimit të Programeve të Banimit.

5. Shuma përfundimtare e financimit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet pas përfundimit të procedurave të projektimit dhe prokurimit, bazuar në vlerën përfundimtare të kontratës apo kontratave të lidhura. Në rastet kur Komuna siguron mjete shtesë nga buxheti i saj për realizimin e Programit të Banimit, këto mjete evidentohen si bashkëfinancim komunal dhe pasqyrohen në dokumentacionin financiar përkatës.

6. Pavarësisht mundësisë së përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, asnjë obligim financiar nuk mund të merret dhe asnjë pagesë nuk mund të bëhet përtej ndarjeve buxhetore të miratuara dhe kornizës ligjore e financiare në fuqi që rregullon zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe Projektit të Banimit Social Adekuat.

Neni 6

Procedurat e prokurimit dhe ekzekutimi i pagesave

1. Procedurat e prokurimit për Programet e Banimit iniciohen dhe zhvillohen nga Komuna, duke vepruar përmes Njësitit për Implementimin të Projektit (NjIP), sipas kodit buxhetor . Kjo Marrëveshje shërben si autorizim ligjor për Komunën që të iniciojë procedurat e prokurimit sipas kodit/kodeve buxhetore të Programeve të Banimit të parapara në këtë Marrëveshje dhe miratuara nga NjMP/MMPH.
2. Të gjitha pagesat ndaj kontraktorëve ekzekutohen nga MMPH/NjMP, në përputhje me procedurat e Thesarit, Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”, pas dorëzimit nga komuna të faturave dhe dokumentet tjetër të kërkuar në MMPH/NjMP.
3. Komuna siguron që të gjitha procedurat e prokurimit të jenë në përputhje me Ligjin përkatës për Prokurimin Publik, kërkesat e pranueshmërisë të Programeve të Banimit dhe manualin e prokurimit në kuadër të MIP-së.
4. Për qëllime të zbatimit të legjislacionit për prokurimin publik, Komuna vepron si Autoritet Kontraktues për procedurat e prokurimit, ndërsa MMPH/NjMP vepron si autoritet financies dhe i pagesave sipas kodit buxhetor të Programit të Banimit Social.

Neni 7

Transferimi i investimit kapital dhe regjistrimi i njësive të banimit social si pronë e Komunës

1. Për njësitë e banimit social në ndërtesa shumë banesore, pas përfundimit të punimeve, pranimit teknik dhe lëshimit të certifikatës së përdorimit, investimi kapital (pasuria – jo financiare) transferohet në pronësi të Komunës, në përputhje me Ligjin përkatës për Pronën Publike dhe Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Komuna siguron regjistrimin e njësive të përfunduara të banimit social në regjistrat përkatës kadastral dhe të pronës së komunës, si pronë e komunës, në përputhje me Ligjin përkatës për Pronën Publike dhe Ligjin përkatës për Kadastër të Pronës së Paluajtshme.
3. Transferimi i aseteve dokumentohet përmes një procedure të pranimit-dorëzimit, të nënshkruar ndërmjet MMPH dhe Komunës pas përfundimit dhe verifikimit të punimeve.

Neni 8

Menaxhimi i njësive të banimit social

Komuna është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e rregullt të njësive të banimit social të ndërtuara ose të renovuara në kuadër të kësaj Marrëveshje, në përputhje me Ligjin Nr. 10/L-022 për Banimin Social dhe të Përballueshëm dhe aktet përkatëse nënligjore për zbatim të tij. Kjo përfshin sigurimin e strukturës ose sistemit komunal për menaxhimin e banimit social, si dhe zbatimin e rregullave për përzgjedhjen e përfituesve, dhënien me qira, lartësinë e qirasë, mirëmbajtjen, monitorimin dhe përdorimin e rregullt të njësive.

Neni 9

Përzgjedhja e përfituesve për nën-projektet

Komuna siguron identifikimin dhe përzgjedhjen e përfituesve për Programet e Banimit që përfshijnë renovimin ose rindërtimin e shtëpive private në kuadër të kësaj Marrëveshje në përputhje me legjislacionin në fuqi, thirrjen Publike përkatëse dhe procedurat, formularët dhe udhëzimet e nxjerra nga MMPH/NjMP për Programet e Banimit përkatës.

Neni 10

Monitorimi dhe raportimi

1. Komuna, përmes NjIP-së së saj, raporton për të gjitha fazat dhe proceset që lidhen me Programet e Banimit që janë objekt i kësaj Marrëveshje dhe dorëzon raporte të rregullta të progresit sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara nga MMPH/NjMP. Një raportim i tillë përfshin gjithashtu përputhshmërinë me detyrimet mjedisore dhe sociale sipas KMMS-së, duke përfshirë trajtimin e ankesave, angazhimin e palëve të interesit, shëndetin dhe sigurinë në punë, incidentet ose aksidentet me ndikime të konsiderueshme, si dhe zbatimin e masave korrigjuese kur është e nevojshme.
2. Komuna dorëzon raporte të rregullta financiare dhe teknike në formatin dhe afatet e përcaktuar nga MMPH.
3. Zyrtarët e Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës - BZHKE-së ose palët e treta të autorizuar mund të kryejnë vizita monitoruese, teknike ose vlerësuese në lokacionet relevante të Programeve të Banimit në çdo fazë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Ndryshimi dhe ndërprerja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të palëve.
2. MMPH rezervon të drejtën ta ndërpresë Marrëveshjen në rast të mosrespektimit të saj nga Komuna.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhet në mënyrë miqësore, ndërsa, në mungesë të një zgjidhjeje të tillë, palët kanë të drejtë të refcojnë çështjen pranë gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mbetet e vlefshme deri më 31 dhjetor 2028, përveç nëse ndërpritet më herët në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje ose zgjatet afati i zbatimit të saj me pëlqim të ndërsjellë të palëve.

Palët nënshkruese:

Për Ministrinë e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
Fitore Pacolli Dalipi

Ministre në detyrë

Data: 25.08.2026, në Drenas



Për Komunën e Drenasit

Ramiz Lladrovci

Kryetar



SHTOJCA 1**SHUMA MAKSIMALE E FINANCIMIT E PARAQITUR SIPAS PROGRAMEVE TË BANIMIT**

Nr	Emri i Komunës	Programi i Banimit	Kodi i NjMP	Shuma maksimale e miratuar në kuadër të projektit PBSA
1	Drenas	Programi për ndërtimin e njësisve të reja të banimit social	DRE-NRS-1.0	2,250,000 Euro
2	Drenas	Programi për renovimin e shtëpive private për familjet e cënueshme.	DRE-REP-3.1	375,000 Euro
3	Drenas	Programi për rindërtimi e shtëpive private për familjet e cënueshme.	DRE-RIP-3.2	385,000 Euro